

EPPC Albania kërkon një **Përfaqësues Shitjesh B2B** për **Univers Promotion**, një ndër kompanitë më të suksesshme në treg me fokus produktet promocionale, printimin dixhital, veshjet e punës dhe sigurinë në punë.

### Përgjegjësitë Kryesore:

1. Identifikimi, rekrutimi dhe kontaktimi i klientëve të rinj nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve të vazhdueshme në treg;
2. Prezantimi dhe promovimi i produkteve tek klientët;
3. Analizimi i plotë i produkteve dhe rekomandimet e duhura tek klientët, me qëllim plotësimin në mënyrë efikase të nevojave dhe kërkesave të tyre;
4. Ndjekja me kujdes dhe përpikmëri e klientëve si dhe negocimi me ta për realizimin e procesit të shitjes;
5. Zhvillimi dhe zbatimi i planit të punës në funksion të planit të biznesit dhe objektivave të kompanisë.

### Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare;
- **Përvojë e mëparshme në shitje;**
- Të jetë **i aftë të punojë në mënyrë të pavarur**, brenda afateve;
- **Të ketë leje drejtimi automjeti;**
- Të zotërojë mirë MS Office.

### Të dhënat:

|                      |  |
|----------------------|--|
| <b>Pozicioni:</b>    | Përfaqësues Shitjesh B2B;                        |
| <b>Vendndodhja:</b>  | Autostradë;                                      |
| <b>Raporton tek:</b> | Drejtori i Përgjithshëm;                         |
| <b>Pagesa:</b>       | Shumë e mirë ( <i>fikse + bonuse + makinë</i> ); |
| <b>Kontrata:</b>     | Sipas Kodit të Punës.                            |

### Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun e mëposhtëm:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.